



Geraldo DURDAJ – Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Trajtimit të Pronave

Av.Geraldo Durdaj ka kryer Studimet Universitare, në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit European të Tiranës.

Në vitin 2017 ka përfunduar studimet pranë Departamentit të së Drejtës Publike. I licencuar si avokat nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë dhe ka ushtruar profesionin në studion Ligjore “Res Judica Partners”, ku është marr kryesisht me çështje të së drejtës Civile, Penale dhe në të Drejtat e Njeriut.

Karrierën profesionale e ka nisur fillimisht në vitin 2010, duke vijuar me praktikat e ndjekura pranë Qendrës “RESPUBLICA”, Drejtorisë së Shërbimit të Provës Zyra Vendore Durrës, Komisionit të Ligjeve dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Prej vitit 2017 Z.Durdaj punoi pranë Drejtorisë së ALUIZNIT Kamëz-Vorë dhe në vitin 2019 puna e tij vijon si Përmbaues Gjyqësor pranë zyrës së Përmbaimit Tiranë.

Gjatë karrierës profesionale ka zhvilluar trajnime afatshkurtra dhe afatgjata mbi monitorimin e institucioneve publike në vend, studime dhe kualifikime ku ka kontribuar në fusha të ndryshme të Drejtësisë. Pjesëmarrës në konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare ku ndër to përmendim ; Konferenca e Katërt e Kombeve të Bashkuara për vendet në zhvillim,dhe modelin e NATO-s në Shqipëri.

Krahas shkencave juridike në përgjithësi, ku angazhimi i tij konsiston si aktivist i të Drejtave të Njeriut, interesat e tij akademike përfshijnë dhe fushën sociale me pjesëmarrjen në projektin FIT and GREEN (Jeto Gjelbër) projekt që socializon të rinjtë e Shqipërisë me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të Europës Juglindore.

Ka disa vite përvojë në ushtrimin e profesionit në institucione të ndryshme ku në vitin 2022 ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme Anti-Koorrupsion, Drejtoria Operacionale, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Aktualisht Z. Durdaj mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Trajtimit të Pronave.